



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TE BRËNDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT

RAPORT
PËR PUNËN DHE PERFORMANCËN E
SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT
PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2015

HYRJE

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2015, veprimtaria e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat është fokusuar në zbatimin e prioriteteve të programit të Qeverisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të vetë Shërbimit, si dhe në detyrimet që rrjedhin në kuadër të Planit Kombëtar të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, rekomandimeve të Progres Raportit të vitit 2014 e 5 prioriteteve kyçe të Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2015 janë realizuar prioritetet, objektivat dhe indikatorët e matshëm të parashikuar në Programin Vjetor të Punës për vitin 2015 të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Ky fakt evidentohet nga treguesit e arritur në:

- Fillimin dhe ecurinë pozitive të implementimit ligjor, organizativ e strukturor të ligjit nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, për ta përqsur me standardet e agjencive të mbikqyrjes së jashtme të vendeve të BE-së, me fokus të veçantë ato të EPAC (European partners against corruption);
- Ndryshimet strukturore dhe organizative, për t’ju përshtatur detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, vendim i cili e parashikon Shërbimin si një nga 3 Autoritetet Verifikuese në vendin tonë;
- Forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit nga punonjës të Strukturave nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit më të ngushtë me prokurorinë por jo vetëm, zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve hetimore, vlerësimit dhe rritjes së hetimeve proaktive;



- Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe besimit të publikut ndaj strukturave të Shërbimit, se denoncimi/ankesa e tyre po trajtohet me paanësi, përgjegjshmëri dhe efikasitet;
- Rritjen e cilësisë së kontrollit dhe vlerësimit të Strukturave, për zbatimin e ligjshmërisë gjatë përmbushjes së detyrës së tyre funksionale;
- Përmirësimin e procedurave dhe standardizimin e punës me statistikat si dhe zbatimin rigoroz të akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me informacionin e klasifikuar dhe sigurinë e tij.

Treguesit e arritur sipas fushave konkrete janë si më poshtë vijon;

I. Hetimi penal i shkeljeve të ligjit nga punonjës të Strukturave

Gjatë periudhës analizuese janë ndaluar/arrestuar **33** persona, ndër të cilët **28** punonjës të Strukturave të niveleve drejtuese e zbatuese dhe **5 shtetas** bashkëpunorë të tyre.

Vlen të theksohet zbatimi i një prirje të re, atë të vlerësimit objektiv ndaj punonjësve të policisë për këto arrestime kryer me vendim nga gjykata, pra kjo flet për një objektivitet maksimal dhe profesionalizëm nga ana e Shërbimit.

Rastet më të spikatura, për nga mënyra e hetimit të tyre, duke përdorur teknikat dhe metodat proaktive të hetimit apo si rezultat i denoncimit nga ana e qytetarëve; denoncimit në median vizive e rrjetet sociale, janë;

- arrestimi i **K/Inspektor Hamëz Demushi** dhe bashkëpunëtorit të tij për trafik të lëndëve narkotike, aktivitet kriminal me shtrirje në Shqipëri e Kosovë. Pas arrestimit në banesën e tij u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një sasi lënde narkotike prej **3.6 kg e dyshuar e llojit kokainë, dhe 0.5 kg e dyshuar heroine.**
- arrestimi i **Inspektor Leonel Begaj** dhe **K/Inspektor Lirim Lamaj**, pasi duke keqpërdorur detyrën kishin pajisur me pasaportë një person të shpallur në kërkim dhe të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për 25 vjet.
- arrestimi i **N/Komisar B.A.** dhe **Komisar I.R.**, për mosreferimin të materialeve proceduriale në rastet e 7 aksidenteve me pasojë dëmtime të personave dhe njëkohësisht nxjerrjen e automjeteve nga pikat e bllokimit.
- ndalimi i **Kol Kukaj, Agim Hysko** dhe **Besjana Martini**, ish-punonjës të Drejtorisë së Prokurimeve, në D.P.P.Shtetit, për abuzime me prokurimin publik për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytetin e Tiranë, i zhvilluar në Dhjetor të vitit 2010.
- arrestimi i **Nevila Mamo dhe Genci Reçi**, dy drejtues të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, të cilët nëpërmjet falsifikimit të dokumentave kanë abuzuar me detyrën, duke shpërdoruar fondet publike, me një dëm ekonomik shkaktuar buxhetit mbi 6 milion lekë të reja, për një periudhë 2- vjecare.



- ndalimi i **Drejtues A.B.**, me detyrë shef i Sektorit të Zyrës Qëndrore Kombëtare të Interpol Tiranë dhe **N/Komisare L.A.**, me detyrë specialiste e këtij sektori, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- arrestimi i **N/Komisar A.Z.**, i cili në zonën që mbulonte, kishte favorizuar ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm të lojrave të fatit dhe në disa raste duke keqpërdorur atributet që i jep detyra kishte fshehur kallëzime të qytetarëve duke mos i referuar ato pranë organit të Prokurorisë, kundrejt shpërblimit financiar.
- arrestimi i shefit të policisë kriminale **Komisar A.L.**, i cili duke keqpërdorur atributet që i jep detyra kishte favorizuar ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm të lojrave të fatit nga disa subjekte të qytetit të Elbasanit, kundrejt shpërblimit financiar.
- arrestimi i **Inspektorit të PKK. Kakavijë Mentor Cane, Inspektorit të PKK Qafë - Botë Sokrat Guga dhe shtetasit Erald Çaçë**, për kontrabandë për mallrat për të cilat paguhet akcizë. Punonjësit e policisë duke shfrytëzuar detyrën siguronin mallin kontrandë, cigare, bashkëpunorët kryenin shitjen e tyre.
- denoncimi i një qytetari në **linjën e gjelbër 0800 90 90** për “korrupsion”, arrestohet **Inspektor Ylli Ulaj**, efektiv i policisë së qarkullimit rrugor Lezhë. Punonjësi i policisë nuk e kishte proceduar administrativisht shtetasin kosovar për shkeljen e konstatuar, por në këmbim i kishte marrë lekë.

Për 28 punonjësit e policisë të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore të Shërbimit gjatë periudhës analizuese, me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit është dhënë masa disiplinore “përfundim nga Policia e Shtetit”.

Gjithashtu në funksion të hetimit penal është bërë referimi i materialeve proceduriale pranë organit të Prokurorisë, për hetim në gjendje të lirë, konkretisht;

- **110** kallëzime penale për
- **132 persona**, nga të cilët
- **2** punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues,
- **37** punonjës policie i nivelit të parë drejtues,
- **86** punonjës policie të nivelit zbatues,
- **4** punonjës policie civil,
- **3** punonjës të Gardës dhe
- **19** shtetas.



II. Vlerësimi i zbatimit të ligjshmërisë nga ana e Strukturave, veprimtari e kryer nga Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2015, janë kryer gjithsej **7 inspektime** në strukturat e DRKM Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë, Korçë, Zyrës së Interpol Tiranë dhe ato të PMNZSH-së.

Nga analiza e konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna për strukturat, objekt inspektimi janë evidentuar këto problematika;

- Raste të moszbatimit korrekt të procedurave standarde të punës të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore “për të huajt”.
- Raste të moszbatimit korrekt të procedurave standarde të punës në lidhje me procedurat e trajtimit të personave të kthyer (INAD) nga palët homologe.
- Raste të moszbatimit korrekt të procedurave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale midis autoriteteve të huaja në çështjet penale.
- Raste të mospërputhje kontradiktore midis parashikimeve të bëra në legjislacionin për “marrëdhëniet juridiksionale midis autoriteteve të huaja në çështjet penale”, me aktet administrative që normojnë punën e strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit.
- Janë konstatuar mangësi në forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me palët homologe në fushën e menaxhimit të kufijve dhe parandalimit të krimit ndërkufitar.
- Edhe pse është rritur cilësia e verifikimit të dokumentacionit për lëvizjen e lirë të personave, duke shtuar në të njëjtën kohë numrin e refuzimeve në kufi të shtetasve me tendencën e kërkimit të azilit, rekomandohet një punë më e mirë në zhvillimin e intervistave të shoqëruara me analiza risku, me qëllim ulje e numrit të shtetasve të kthyer (INAD) nga palët homologe.

Ndërsa gjatë inspektimit në strukturat e PMNZH-ve, u konstatua se:

- Edhe pse vlerësohet punë e mirë e kryer deri më tani në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës në PMNZSH-të e Qarqeve, Tiranë (21-dhjetori), Shkodër (qendër), Dibër (qendër), Elbasan (qendër), Gjirokastrë (qendër), nevojiten sërish fonde për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve për të qënë në përputhje me standardet e vendeve të BE-së.

Mbi konstatimet dhe rekomandimet e dhëna në raportet e inspektimit, Strukturat objekt inspektimi, nuk kanë bërë observacione apo komente, por i kanë pranuar ato, duke ndërmarrë masat konkrete për ndryshimin e gjendjes dhe përmirësimin e saj.



III. Hetimi administrativ,

Nëpërmjet marrjes nga të gjitha portat e komunikimit që SH.Ç.B.A ka ngritur në dispozicion të publikut, administrimit, vlerësimit sipas karakterit dhe kthimit të përgjigjes për **472** ankesa dhe **2292** telefonata në linjën e gjelbër **080 90 90**.

Nga procesi i vlerësimit, analizimit dhe trajtimit të ankesave ka rezultuar se;

- Për **4 punonjës policie**, objekt ankimimi, është bërë referimi në organin e Prokurorisë;
- Për **33 punonjës policie**, objekt ankimimi, është sugjeruar fillimi i ecursë disiplinore pranë strukturës kompetente të Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit.

Nga analizimi i gjithë produktit të përfutur gjatë hetimit administrativ të ankesave janë evidentuar si trend i shkeljeve administrative, ***kryesisht ato të mosushtrimit të kompetencave policore të miratuara në Procedurat Standarde të Punës.***

IV. Implementimi ligjor i ligjit nr. 70/2014

Në kuadër të implementimit janë realizuar detyrimet ligjore nëpërmjet hartimit dhe miratimit të;

Udhëzimet e Përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë të Përgjithshme “Në lidhje me procedurat e veprimtarisë informative të Shërbimit”; Urdhra të Ministrisë së Punëve të Brendshme për “Strukturën e Shërbimit” dhe “Rregulloren e Kartotekës së Shërbimit”; Urdhra të Ministrisë së Punëve të Brendshme që përcaktojnë procedurat e sigurimit të personelit të strukturave të Ministrisë si dhe funksionet që njihen me informacion të klasifikuar; Urdhra të Drejtorisë së Shërbimit që “normojnë dhe standardizojnë modelet statistikore të prodhuara në funksion të veprimtarive të Shërbimit, procedurat që ndiqen gjatë trajtimit dhe inspektimit të ankesave të publikut”.

V. Implementimi organizativo-strukturor i ligjit nr. 70/2014

Këtu është synuar rritja profesionale e personelit të Shërbimit dhe diversitetit gjinor, të arritura me;

- Rekrutimet e reja kryesisht **me arsim juridik**, duke zëvendësuar personelin me background policor apo nga shërbimet informative, në funksion të rregullimit të raportit të barabartë midis personelit me gradë dhe personelit pa gradë (punonjës civil).
- Vlen të theksohet dukshëm një arritje e inicuar nga politika e qeverisë dhe e **Z. Kryeministër** mbi diversitetin gjinor, duke rritur në % të konsiderueshme numrin e punonjëseve femra në Shërbim, nga rreth **5% në rreth 18 %** të totalit të personelit, kryesisht në strukturat e Shërbimit që janë kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, Sektori i Inspektimit të Ankesave.



VI. Realizimi i treguesve të buxhetit për periudhën Janar - Qershor 2015

Art.	Emërtimi	Plani vjetor	Plani 6-mujor	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %
600	Paga & shpenz. personeli	114,742,000	54,370,800	52,225,148	2,145,652	96 %
601	Sigurime shoqerore	20,344,000	10,171,800	8,635,213	1,536,587	85 %
602	Mallra e shërbime	29,000,000	21,550,000	13,116,303	8,433,697	61 %
606	Transf.buxhetet familjare	8,000,000	4,580,000	1,984,064	2,595,936	43 %
231	Investime	0	0	0	0	0
TOTALI		172,086,000	90,672,600	75,960,728	14,711,872	84 %

Realizimi i fondit për “Paga dhe shpenzime të tjera personeli” (artik.600)

Në këtë artikull fondet janë realizuar në shumën prej 52,225,148 lekë ose **96% e planit**. Mosrealizimi 100% rezulton nga mosplotësimi i strukturës (gjatë periudhës 6-mujore) me personel prej 5-10 punonjësish.

Realizimi i fondit për “Sigurimet shoqërore & shendetësore” (artik.601)

Fondet e planifikuara për periudhën 6-mujore janë në shumën prej 10,171,800 lekë, nga të cilat është realizuar shuma prej 8,635,213 lekë ose **85% e planit**.

Realizimi i fondit për “Mallra e shërbime të tjera” (artik.602)

Nga fondet e planifikuara në këtë zë, janë realizuar fondet në shumën prej 13,116,303 lekë ose **61% e planit**, me një diferencë në vlerë prej 8,433,697 lekë. Mosrealizimet në këtë artikull kryesisht kanë ardhur si rezultat i mospërdorimit të planifikuara për “Shpenzime transporti” dhe “Shpenzime të tjera operative”. Ky i fundit përdoret, me urdhër të posaçëm nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit, në funksion të veprimtarisë informative dhe procedurale penale.

Realizimi i fondit për “Transferim për buxhetet familjare & individë”(artik.606)

Fondet në këtë artikull janë realizuar në shumën prej 1,984,064 lekë ose **43% e planit**. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mospërfundimit të implementimit të plotë të strukturës dhe përbërjes së re organike të Shërbimit, proces nga i cili do të ketë edhe punonjës që do të dalin në reformë.

